

**Hapet thirrja për aplikime për shkëmbimin e studentëve të Universitetit të Tiranës, me Universitetin Ndërkombëtar të Katalunja-s, Barcelonë, Spanjë, në kuadër të Marrëveshjes Bilaterale ndërmjet dy Istitucioneve.**

Në kuadër të Marrëveshjes Bilaterale me Universitetin Ndërkombëtar të Katalunja-s, Barcelonë, Spanjë, Universiteti i Tiranës hap thirrjen mbi shkëmbimin e studentëve në fushat (shiko linkun)

- <http://www.uic.es/en/studies-uic/humanities/degree-humanities-cultural-studies>
- <http://www.uic.es/en/communication-sciences>

Lloji i mobilitetit /kohëzgjatja:

Shkëmbimin e studentëve për studime;

-Simestrin e parë të vitit 2019-2020

-Vitin e plotë Akademik 2019-2020

Studentët të cilët dëshirojnë të aplikojnë nuk do të paguajnë tarifën e shkollimit në Universitetin Ndërkombëtar të Katalunja-s, por do të vazhdojnë të paguajnë tarifën e tyre të shkollimit në Universitetin e Tiranës.

Studentët do të paguajnë në Universitetin pritës shumë prej 200 Euro, për shpenzime administrative.

Shpenzimet e akomodimit dhe udhëtimit do të paguhet nga vetë studenti.

Mund të aplikojnë vetëm studentë të vitit I-rë dhe II-të niveli Bachelor.

Dokumentat e kërkuara janë;

-CV

-Listë Notash (e përkthyer në mënyrë zyrtare)

-Leter Motivimi

-Vërtetim Studenti (e përkthyer në mënyrë zyrtare)

-Certifikatë e Gjuhës së Huaj B2 (DELE, TOEFL (paper based, computer based, internet based), IELTS, CAMBRIDGE etc)

-Fotokopje Pashaporte

- Policë Sigurimi Shëndetësor për periudhën e studimit (ky dokument do të dorëzohet në një fazë të dytë, pra jo në momentin e aplikimit fillestar)

**Afati për aplikim: 03 Maj 2019**

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si edhe të skanuara përmes postës elektronike në adresën [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Universiteti i Tiranës ju uron Suksese në aplikim!